



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.98/2024
Datë: 11 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen 324-të, të mbajtur me datë 11 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi për implementimin dhe zhvillimin e sistemit e-Pagesat.
- II. Themelohet grupi punues për implementimin dhe zhvillimin e sistemit e-Pagesat, në përbërjen si në vijim:
 1. Vehbi Behluli, drejtor i Departamentit për Buxhet dhe Financa në SKGJK;
 2. Ilaz Papaj, udhëheqës i divizionit për Buxhet dhe Financa në SKGJK;
 3. Bahtije Rashica, udhëheqëse e divizionit për të hyra dhe pasuri në SKGJK;
 4. Gazmend Gashi, zyrtar i të hyrave Gjykata Themelore Prishtinë;
 5. Adriana Grapci, zyrtare e të hyrave Gjykata Themelore Pejë;
 6. Ardian Berisha, udhëheqës i divizionit të aplikacioneve në SKGJK;
 7. Vahdetdin Buzolli, ueb administrator në SKGJK.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 11 prill 2024

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 11 prill 2024, ka miratuar propozimin zhvillimin dhe implementimin e sistemit E-Pagesat, i cili sistem do t'u mundësoj qytetarëve të Republikës së Kosovës të realizojnë pagesat e taksave gjyqësore dhe gjobave nga cilido vend dhe pajisje që ka qasje në internet.

Po ashtu, Këshilli ka themeluar grup punues i cili do të përkrah zhvillimin dhe implementimin e këtij sistemi, në përbërjen si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues;
- Sekretariatit të KGJK-së dhe Arkivit.

